



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës/ Opština Podujevo /Municipality of Podujeva**



Për: Kryetarin e Komunës , Z.Shpejtim Bulliqi
Nënkryetaren e Komunës, Znj.Marigona Lahu

Nga: Njësitë për të Drejtat e Njeriut-NJDNJ.

Qeshtja: Përmbledhja e aktiviteteve dhe punëve të cilat i ka realizuar , Njësitë për të Drejtat e Njeriut- NJDNJ .

-NJDNJ,si pjesë përbërëse e Organogramit të Komunës, në Zyren e Kryetarit ,ka realizuar aktivitetet në kuadër të detyrave dhe përgjegjesisë, për të përmbushur obligimet që ka ky njësitë në kuadër të shërbimit civil të Komunës.

-Puna kontinuele dhe koherente e përfshinë njësitin në funksionin e realizimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe grupet e rrezikuara,margjinalizuara si dhe realizimi në funksion të barazisë gjinore.

-Është bërë raportimi në kohën e kërkuar nga MAPL, për qeshtjet e Zbatimit të Barazisë Gjinore, dhe të Drejtave të Njeriut,janë zhvilluar aktivitete me institucionet relevante në kuadër të fushatave vetëdisuese për realizimin e Barazisë Gjinore, e në fokus të vëmendjes regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve ,sipas udhëzimit administrativ për regjistrim të pronës në emër të të dy bashkëshortëve.

-Është vazhduar aktiviteti i punës me Mekanizmin Lokal Kunder Dhunës në Familje , përfshirë trajnimet dhe takimet e punës,në mënyrë që ky mekanizëm të jetë më funksional, dhe të ndikojë në vetëdisimin e qytetarëve për dhunën në familje, si masë parandaluese,për këtë kemi takime të rregullta me: QPS,Policia, QKMF, Agjensioni për Punësim,Drejtoria e Arsimit-DKA,Drejtoria e Shëndetësisë-DSHMS,Gjykata etj.

-Është realizuar aktiviteti „8 Marsi” Dita Ndërkombëtare e Gruas,të cilë i ka paraprirë përgatitja dhe publikimi i flatë-palosjes “ Të Drejtat e Grave dhe Ligji për Barazi Gjinore”.

-Në bashkëpunim me, GIZ –in Gjerman, janë realizuar takime me gratë në biznes ,për mundësinë e përfitimit të Granteve për bizneset e tyre.

-Në kuadër të aktivitetit për të drejtat e njeriut, është realizuar një punëtori tre ditore “ Online “,me temën :
Procedurat Juridike për Mbrojtjen e së Drejtës kundër Diskriminimit në Kosovë.

-Është realizuar edhe një trajnim ,në kuadër të vetëdijësimit kundër punëve të rënda për të miturit.

-NJDNJ, ka marrë pjesë , dhe ka punuar në hartimin dhe harmonizimin e Rregullores , për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve,

Të cilën së bashku me ekipet dhe me zyrtarët relevant e ka finalizuar , dhe është proceduar si Projekt-Rregullore,për miratim nga Kuvendi Komunal .

-Zyrtarët e NJDNJ-së, i vijnë te gjitha trajnimet e nevojshme ,të cilat ftohen nga institucionet shtetërore, që merren me këtë fushë ,dhe organizata tjera jo-qeveritare.

-Takime me organizaten PAVE-LMAV, me temën: Parandalimi dhe adresimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes Reziliencës së Komunitetit në Ballkan.

-Pjesëmarrja e rregulltë e trajnimit për “Performancë Komunale” në pikat që qëndrojmë më ultë , në menyrë që të ngritet niveli i performancës, në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët.